

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: "ALEN – CO" sh.p.k, NIPT K83213401M, Adresa: Fier Zharëz, Rruga Fier-Berat Km.10, Godina Nr.7, Hyrja Nr.2, Kati i parë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur, me mjete elektronike.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF - 00271-07-06-2021.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Furnizim instalim elemente bateri stacionare akumulatore acide, elemente 2VDC, 300Ah, për dy sallat 48V në ndërtesën e centralit dhe për një salle 220VDC në N/Stacionin 220kV, me aksesoret përkates të montimit dhe instalimit, për HEC Fierzë".

Kohëzgjatja e kontratës: 6 (gjashtë) muaj, nga hyrja në fuqi e kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Datë 12.07.2021, Nr.109.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Aleksander Harizi, person fizik, NIPT L91401023I pa ofertë;
- 2- "Sinteza Co" sh.p.k, NIPT K11324003F, me ofertë ekonomike 13,439,000 (Trembëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH;
- 3- "ALEN-CO" sh.p.k, NIPT K83213401M, me ofertë ekonomike 14,400,000 (Katërmëdhjetë milion e katërqind mijë) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1- Aleksander Harizi, person fizik, NIPT L91401023I, pasi ka paraqitur vetëm ekstraktin e thjeshte dhe asgjë nga kriteret për kualifikim të kërkuara në DT.

2- Sinteza Co sh.p.k, NIPT K11324003F pasi:

1- Operatori Ekonomik ka paraqitur deklaratë nga prodhuesi se afati i shërbimit për bateritë do të jetë në përputhje me afatin e përcaktuar në specifikimet teknike. Ne dokumentin e paraqitur me emrin "DEKLARATE_RITAR", kjo deklaratë nga Hengyang Ritar Power Co., Ltd edhe pse është paraqitur si e noterizuar nuk është e përkthyer në shqip (dokumenti në origjinal përmban shkrime në anglisht dhe në shqip). Kjo deklaratë mban datën 29/03/2021 ndërkohë që procedura është publikuar në sistemin e APP-së datë 07/07/2021.

2- Nuk ka paraqitur asnjë katalog dhe/ose autorizim prodhuesi/distributori dhe/ose deshmi të testimeve zyrtare (nëse mallrat e ofruara janë subjekt i testimeve) dhe/ose deklarate të konformitetit CE (nëse këto mallra janë subjekt i certifikimit CE) për të gjithë produktet e zërit numer 9. Produktet e zërit numer 9 janë:

- Set me hidrometër dhe termometër,
- Vazelinë për ruajtjen e kontakteve dhe terminaleve nga oksidimi,
- Seti për shpëlarjen e syve

2.1 Nuk ka paraqit dëshmi të testimeve për bateritë e ofruara. Raporti i inspektimit i paraqitur nuk është raport testimi.

Pra pika 2.3.4 e kriterëve të vecanta për kualifikim nuk përmbushet nga ky operator.

3- Terminalet + dhe – janë kërkuar për t'u lidhur me bulon M10, në katalog paraqitet bulon M8.

4- Katalogu i paraqitur nuk është i aksesueshem në faqen e website si dhe përmbajtja e tij nuk është në përputhje me specifikimet teknike. Nuk jepen të dhëna në lidhje me pajisjet e shërbimit dhe mirëmbajtjes së baterive si dhe bazamentin.

5- Mostra e paraqitur është pa elektrolit, rrjedhimisht bateria e paraqitur nuk është sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "ALEN-CO" sh.p.k, NIPT K83213401M, me adresë: Fier Zharëz, Rruga Fier-Berat Km.10, Godina Nr.7, Hyrja Nr.2, Kati i parë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 14,400,000 (Katërmëdhjetë milion e katërqind mijë) Lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23/12/2020, "Për Prokurimin Publik".

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ERGYS VERDHO